



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 844/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazic dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shpresa Azemi Shemsedini për subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Ferat Mustafës – Komisioner dega në Ferizaj dhe Kadri Ismajlit – Kryekomisioner dega në Ferizaj, për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat: Anr.844/13, Anr.845/13, të datës 12.11.2013, të Shpresa Azemi Shemsedinit nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.844/13, Anr.845/13, me datë 12.11.2013, nga Shpresa Azemi Shemsedini të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj ku pretendohet se :

- Në ankesën Anr.844/13 të datës 12.11.2013, pretendohet se brenda në vendvotim mu janë keqpërdorur dhe manipuluar votat, prandaj kërkoj edhe një herë numërimin e votave të secilit kandidat.
- Në ankesën Anr.845/13 të datës 12.11.2013, pretendohet se brenda në vendvotim mu janë keqpërdorur dhe manipuluar votat, prandaj kërkoj edhe një herë numërimin e votave.

Bazuar ne nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Me nenin 118.4 të LZP-së parashihet se : “Mund të apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.

Me ankesat e parashtruara nga Shpresa Azemi Shemsedini (PDK) pretendohet se, në vendvotimet VV e caktuara është keqpërdorur dhe manipuluar me votat nga komisioneri Ferat Mustafa dhe kryekomisioneri Kadri Ismajli, mirëpo një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i paçartë për tu vërtetuar.

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, pasi që mungojnë provat me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 844/2013 më datën 12.11.2013



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.